

VENDIM
Nr. 4191, datë 28.9.2022

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE
NË UDHËZIMIN NR. 3241, DATË 18.12.2014, “PËR SIGURIMIN E
DEPOZITAVE NË BANKA”, TË NDRYSHUAR**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 3, pika 2, dhe 4, nenit 11, shkronja “c”, nenit 25, shkronjat “ç” “d”, “dh” dhe “e”, nenit 26, pika 2, nenit 27, pika 1, nenit 43, pika 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “g”, nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar; si dhe të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 24, datë 29.8.2022,

VENDOSA:

I. Në udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si vijon:

1. Në nenin 4, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “g” fjala “*kujdestari*” zëvendësohet me fjalën “*banka agjente*”.

b) pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) “*Paraqitja unike e depozituesve (Single Customer View)*” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike, në sistemin informatik të bankës, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përcaktohen saktë depozitat e sigurueshme, si dhe shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.”.

2. Në nenin 14, pika 10, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “f” me përmbajtjen e mëposhtme:

“f) *miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë.*”.

3. Në nenin 17, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. *Agjencia zotëron Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, me qëllim raportimin e informacionit për paraqitjen unike të depozituesve nga bankat anëtare të skemës, verifikimin e saktësisë të informacionit të raportuar dhe përdorimin e tij në funksion të sigurimit dhe kompensimit të depozitave.*”.

4. Neni 19 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“*Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë dhe raportimi i të dhënave në të nga bankat funksionon në mënyrë të tillë që të sigurojë:*

a) *Ngarkimin nga bankat anëtare të skemës të skedarëve me të dhënat për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe të depozituesve të përjashtuar nga skema, sa herë që kërkohet nga Agjencia, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi;*

b) *Kryerjen e kontrolleve për vlerësimin e saktësisë së skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi;*

c) *Krijimin e listë – pagesës me paraqitjen unike të depozituesve, si dhe dërgimin e saj, në rast simulimi ose kompensimi, në subjektet e përcaktuara në aktet nënligjore të Agjencisë;*

d) *Vlerësimin e saktësisë të përllogaritjes të shumës së siguruar dhe të përllogaritjes të primit të sigurimit të depozitave;*

e) *Vlerësimin e saktësisë të përllogaritjes të shumës së kompensimit në rast simulimi ose ngjarjeje sigurimi;*

f) *Prodhimin e raporteve periodike dhe atyre të kërkuara rast pas rasti nga Agjencia, për qëllim të kryerjes së analizave statistikore dhe vlerësimeve të nevojshme.*”.

5. Në nenin 20, pika 1, pas fjalëve “... mbi gjendjen e depozitave” shtohen fjalët “..., të nevojshme për vlerësimin e saktësisë së llogaritjes së primit të sigurimit, si dhe saktësisë së paraqitjes unike të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi.”.

6. Në nenin 21, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 3 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Likuidatori dhe banka agente kanë të drejtën të njihen me informacionin që përpunohet në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, në përputhje me të drejtat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.”

b) Pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Në rast ngjarjeje sigurimi, depozituesit kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi shumën e kompensimit, që ata përfitojnë, pranë Agjencisë, likuidatorit, ose bankës agente.”

7. Në nenin 22, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët *“... sipas nenit 20 të këtij udhëzimi ...”* zëvendësohen me fjalët *“... sipas dispozitave të këtij udhëzimi”*.

b) Pika 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Autenticiteti i të dhënave të raportuara nga bankat anëtare të skemës në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, si dhe pandryshueshmëria e tyre verifikohet nga bankat nëpërmjet kodit të gjeneruar menjëherë, pas raportimit të suksesshëm dhe të sigurt të të dhënave. Ky kod siguron se të dhënat e transmetuara kanë mbetur të pandryshuara dhe janë origjinale me dhënat e dërguara nga bankat.”

c) Në pikën 7, pas fjalëve *“... për periudha dhe qëllime specifike”*, shtohen fjalët *“..., të përcaktuara në këtë udhëzim”*.

d) Pika 8 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“8. Për qëllim të përlllogaritjes të shumës së sigurimit bankat ngarkojnë, çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës, skedarin përkatës të depozitave të sigurueshme dhe të pasigurueshme, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.”

e) Pika 10 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në rast procesi kompensimi ose simulimi nga Agjencia, bankës do t'i kërkojë të ngarkojë skedarë ditorë për paraqitjen unike të depozituesve, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë me të dhëna mbi:

a) Depozitat – të dhënat për çdo depozitë të sigurueshme dhe të pasigurueshme në bankë;

b) Depozituesit – të dhënat e detajuara të depozituesve të siguruar dhe të përjashtuar nga skema që i identifikojnë ata saktësisht;

c) Kreditë – kreditë e detajuara të lidhura me depozitat që janë vënë si garanci për këto kredi;

d) Pozicioni i netuar i depozituesve – depozituesit në pozicionin e netimit.”

f. Pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“10/1. Agjencia në rast simulimi, ka të drejtën të kërkojë, nga bankat anëtare të skemës, ngarkimin e skedarit për depozituesit, të përcaktuar në pikën 10, shkronja “b” të këtij neni, me të dhëna të anonimizuara, sipas udhëzimeve të saj.”

8. Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“2. Banka dërgon për miratim pranë Agjencisë kërkesën për krijimin e përdoruesit të autorizuar ose mbylljen e tij, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 8 të këtij udhëzimi, si dhe kërkesën për akses në rrjetin privat virtual (VPN), sipas formatit të kërkesës të përcaktuar në aneksin 8/1 të këtij udhëzimi.”

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. Përdoruesit e autorizuar të bankave zbatojnë udhëzimet e Agjencisë për aksesin në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, nëpërmjet rrjetit virtual (VPN). Në rast se përdoruesi i autorizuar nuk është aktiv për më shumë se tre muaj, Agjencia ka të drejtë të kryejë çaktivizimin e tij. Riaktivizimi i përdoruesit mund të bëhet me kërkesë me e-mail nga banka, dërguar personit të autorizuar të Agjencisë.”

9. Në nenin 27, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“1. Agjencia ruan të dhënat për përlllogaritjen e primit të sigurimit për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare) nga data e raportimit të skedarëve të depozitave në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim. Agjencia ruan të dhënat për procesin e simulimit vetëm gjatë kohëzgjatjes së këtij procesi.”

b) Në pikën 2, fjalët *“... në sistemin informatik informacionin dhe të dhënat e raportuara për depozitat ...”* zëvendësohen me fjalët *“... në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim informacionin dhe të dhënat e raportuara për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe listëpagesën e depozituesve, ...”*.

c) Në pikën 3, fjalët *“Pas përfundimit të afatit të lartpërmendur, ...”* zëvendësohen me fjalët *“Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në këtë nen, ...”*.

10. Në nenin 28, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në emërtimin e nenit, pas fjalëve "... për mbajtjen e regjistrat të tyre elektronik ..." shtohen fjalët "... për paraqitjen unike të depozituesve".

b) Në pikën 1, pas fjalëve "... në përputhje me anekset 4, 5 të këtij udhëzimi." shtohen fjalët "..., për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet, nga data e raportimit të këtyre të dhënave në Agjenci."

c) Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Bankat mundësojnë gatishmërinë e prodhimit të skedarëve për krijimin e paraqitjes unike të depozituesve, në çdo kohë dhe sipas kërkesës së Agjencisë, në përputhje me aneksin 5 të këtij udhëzimi."

d) Pika 3 shfuqizohet.

e) Në pikën 5, fjalët "..., si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme lidhur me përfshirjen e tyre në sistemin informatik dhe zbatimin e akteve nënligjore përkatëse.", zëvendësohen me fjalët "..., si dhe lidhur me mbajtjen, përgatitjen dhe raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe auditonjë përputhshmërinë e zbatimit të kërkesave të Agjencisë, sipas dispozitave të këtij udhëzimi."

11. Në nenin 30, pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Raportin për depozituesin me informacionin përkatës, që nxirret nga Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë, në rast ngjarjeje sigurimi, bazuar në kërkesën e tij."

12. Neni 33 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Agjencia kryen verifikime për kontrollin e përmbushjes së kushteve për sigurimin dhe kompensimin e depozitave nga bankat, të cilat paraqesin kërkesë për t'u anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave, bankat anëtare të skemës, si dhe bankat që janë në proces të riorganizimit juridik.

2. Për qëllim të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, llojet e verifikimeve që kryhen nga Agjencia janë:

a) verifikime të plota, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 34 pika 1 të këtij udhëzimi;

b) verifikime të pjesshme, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 34, pika 2, të këtij udhëzimi.

3. Agjencia ka të drejtë të kryejë:

a) verifikimet në vend, në ambientet e bankës;

b) verifikime në distancë, nëpërmjet raportimeve të të dhënave dhe informacionit nga bankat në Agjenci;

c) verifikime të kombinuara, duke kryer një pjesë të punës nga ambientet e Agjencisë dhe një pjesë të punës në ambientet e bankës.

4. Frekuenca e kryerjes së verifikimeve të Agjencisë është si vijon:

a) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në vit, gjatë tre viteve të para të anëtarësimit të bankave në skemën e sigurimit të depozitave;

b) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në dy vjet, për bankat të cilat janë më shumë se tre vjet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;

c) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, çdo tre muaj, me objekt kontrollin e saktësisë së përllëgaritjes të primit të sigurimit, të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

d) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, të paktën një herë në vit, me objekt kontrollin e gatishmërisë së sistemit të bankave anëtare, për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim.

5. Agjencia sipas rastit kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të saj në ekzaminimet, që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në banka.

6. Agjencia verifikon bankat nëpërmjet Grupit të Verifikimit, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë, sipas çështjeve konkrete të verifikimit.

7. Gjatë procesit të verifikimit bankat kanë këto të drejta:

a) e drejta për t'u informuar me programin e verifikimit, i cili përmban objektin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e procesit të verifikimit. Agjencia njofton bankat të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së planifikuar për kryerjen e verifikimit. Si përjashtim nga kjo rregull, në raste të veçanta, kur është i nevojshëm kryerja e verifikimit të menjëhershëm, afati i njoftimit mund të jetë më i shkurtër, por në çdo rast i shoqëruar me një shkresë nga drejtori i përgjithshëm;

b) e drejta për të komunikuar me grupin e verifikimit me qëllim informimin mbi ecurinë e procesit të verifikimit;

c) e drejta për të shprehur komentet në lidhje me gjetjet dhe përfundimet paraprake të procesit të verifikimit. Përfundimet paraprake, që do të jenë pjesë e raportit të verifikimit, i dërgohen me e-mail bankës për komente

përfundimtare, të cilat duhet të paraqiten nga banka brenda 5 (pesë) ditësh pune. Nëse banka nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, raporti i verifikimit do të konsiderohet i dakordësuar;

d) e drejta për të marrë nga Agjencia një kopje të raportit përfundimtar të verifikimit.

8. Gjatë procesit të verifikimit bankat kanë këto detyrime:

a) të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për mbarëvajtjen e punës të Grupit të Verifikimit, siç janë, por pa u kufizuar: mjedise pune të dedikuara për anëtarët e grupit të verifikimit, akses në internet dhe telefon etj.;

b) të vendosin në dispozicion të Grupit të Verifikimit informacionin, të dhënat dhe dokumentet, që kanë lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave, brenda afateve dhe në formën e kërkuar prej tij;

c) të sigurojnë disponueshmërinë e personave të kontaktit dhe përgjegjës të bankës për të bashkëpunuar dhe të marrë pjesë në intervistat me Grupin e Verifikimit;

d) të sigurojnë vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit, të të dhënave dhe dokumenteve, që i paraqiten Grupit të Verifikimit të Agjencisë;

e) t'i mundësojnë Grupit të Verifikimit, nëpërmjet personave përgjegjës të bankës, akses në sistemet informatike, që përpunojnë të dhëna për depozitat dhe depozituesit, me qëllim verifikimin e tyre;

f) të zbatojnë rekomandimet, veprimet dhe/ose masat rregulluese të përcaktuara në Raportin e Verifikimit, si dhe të raportojnë në Agjenci lidhur me ecurinë e zbatimit të tyre, në mënyrën dhe afatin e kërkuar.”.

13. Në nenin 34, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalia “Drejtimit kryesore të procesit të verifikimit janë, por pa u kufizuar:” zëvendësohet me fjalinë “Verifikimet e plota që Agjencia kryen në banka kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme, por pa u kufizuar:”.

b) Në pikën 1, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “b/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“b/1. Verifikimi i bankës, për:

i. saktësinë e përgatitjes dhe ngarkimit në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve;

ii. gatishmërinë e sistemit elektronik të bankës për të gjeneruar raportin e cilësisë së të dhënave, sipas formatit të përcaktuar nga Agjencia;”

c) Pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Verifikimet e pjesshme që Agjencia kryen në banka kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme:

a) saktësinë e përllogaritjes të primit të sigurimit të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

b) gatishmërinë e bankave për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

c) çështje të tjera me tematikë të caktuar në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave.”.

14. Aneksi 4 i udhëzimit riemërtohet “Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të bankës për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

15. Aneksi 5 i udhëzimit riemërtohet “Parametrat teknikë që duhet të plotësojë, dhe raportet që duhet të gjenerojë sistemi informatik i bankës për regjistrin elektronik të detyrimeve depozitë për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

16. Aneksi 8 i udhëzimit “Kërkesë për akses në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim” zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Pas aneksit 8 të udhëzimit shtohet aneksi 8/1, “Kërkesë për akses në rrjetin privat virtual (VPN)”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Në Aneksin 10, formulari 2 i udhëzimit, “Aneks i kontratës së depozitës për informimin e publikut”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

19. Aneksi 17 i udhëzimit, “Raporti mujor i përputhshmërisë të balancave të depozitave, sipas bilancit të përgjithshëm me formatin e fluksit të depozitave të dërguar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

20. Termat “sistem”, “sistemi i Agjencisë”, “sistemi informatik”, “sistemi informativ” dhe “sistemi elektronik” zëvendësohen me termin “Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim”, përkatësisht në nenin 4, pika 1, shkronja “g”; në nenin 13, pika 6; në nenin 18; në nenin 21, pika 1, pika 2; në nenin 22, pika 1, pika 2, pika 6; në nenin 23, pika 4, pika 5, pika 6; në nenin 24; në nenin 25, pika 3; në nenin 26 – emërtimi, pika 1 dhe pika 3; në nenin 27 – emërtimi; në nenin 28, pika 4, pika 6; në nenin 29; në nenin 30 – emërtimi, pika 1; në nenin 31, pika 1 dhe në nenin 32 të udhëzimit.

II. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

III. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

GUVERNATORI
Gent Sejko

ANEKSI 4

REGJISTRI ELEKTRONIK I DETYRIMEVE DEPOZITË TË BANKËS PËR PARAQITJEN UNIKE TË DEPOZITUESVE

Bankat mbajnë informacione dhe të dhëna të sakta e të detajuara për paraqitjen unike të depozituesve, si vijon:

1. Mban dhe siguron me një kod të vetëm (unik) çdo depozitues me këto të dhëna të detyrueshme (në sistemin elektronik të bankës dhe në letër):

a) të dhënat për individët: emër, mbiemër, atësi, **numër personal, të dhënat për mjetin e identifikimit**, gjini, datëlindjen, adresë, numër telefoni;

b) të dhënat për tregtarët dhe shoqëritë tregtare: **numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)**, data e regjistrimit, emërtimi i subjektit, forma ligjore.

c) të dhënat për depozitat: kodi unik i depozitës, tipin e depozitës, numrin e titullarëve të depozitës dhe lidhjen e tyre me depozitat përkatëse; balancën e depozitës, monedha e depozitës, norma e interesit, interesin e llogaritur në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, kursi i këmbimit.

2. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave kolateral ose të vendosura si garanci dhe të dhënat analitike të kredive të bankës për të cilat këto depozita janë barrësuar;

3. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin në sistemet elektronike të informacionit të të dhënave analitike për kreditë që ka çdo depozitues në bankë;

4. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve me/pa kusht dhe afat përfitimimi me të dhënat analitike të kontratave përkatëse;

5. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit për depozitat dhe depozituesit e bankës, që janë të përjashtuar nga skema e sigurimit të depozitave;

6. Mban dhe siguron identifikimin dhe gjurmimin, nëse dërgesat dhe instrumentet e pagesave (p.sh., urdhër në arkë, transfera ndërbankare, transfera nëpërmjet internetit e të tjera transfera elektronike) janë të bëra nëpërmjet pagesave “cash” ose duke debituar llogarinë e depozitës. Kjo gatishmëri është në funksion të administrimit e rregullimeve, që lidhen me balancat e depozitave, me dërgesat pezull dhe faturat gjendje – të pagueshme;

7. Mban dhe siguron gjurmimin nëse çeqet e kredituara nga llogaritë e depozitave janë ekzekutuar (ose imazhi i çeqeve të dëmtuar, është dërguar) për klering. Ky informacion përcakton nëse shumat e depozitave të siguruara duhet të korrigjohen për efekt të çeqeve të paekzekutuara për klering dhe çeqet e kthyer mbrapsht.

ANEKSI 5

PARAMETRAT TEKNIKË QË DUHET TË PLOTËSOJË DHE RAPORTET QË DUHET TË GJENEROJË SISTEMI INFORMATIK I BANKËS PËR REGJISTRIN

ELEKTRONIK TË DETYRIMEVE DEPOZITË PËR PARAQITJEN UNIKE TË DEPOZITUESVE

1. Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë, vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

- a) shuma e mbulimit;
- b) kursi zyrtar i këmbimit në ditën e vlerësimit;
- c) kodin unik të identifikimit të depozituesit;
- d) të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt i skemës;
- e) të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;
- f) detyrime të tjera të depozituesit ndaj të tretëve;
- g) kushtet përjashtuese sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

2. Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

- a) Paraqitjen unike të çdo depozituesi (individ, tregtar, shoqëri tregtare) të bankës, lidhur me:
 - i. të dhënat identifikuese të tij;
 - ii. depozitat e tij (secilën nga depozitat dhe të marra së bashku);
 - iii. detyrimet në vonesë ndaj bankës (kredi, *overdraft*, garanci etj., çdo detyrim më vete, si dhe të marra së bashku);
 - iv. pozicionin neto të tij (depozita–kredi, të drejta-detyrime në vonesë);
- b) listën e plotë e depozituesve të bankës që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;
- c) listën e depozituesëve të bankës që nuk janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;
- d) listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;
- e) konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit i përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, sipas kërkesës së Agjencisë;
- f) listën e depozituesve që kanë një detyrim kundrejt bankës, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;
- g) listën e depozituesve që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, e shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;
- h) listën e depozituesve me shumën e kësteve të papaguara në afat që burojnë nga marrëdhënia kreditore e depozituesit me subjektin;
- i) evidentimi i depozitave kolateral dhe i depozitave të vendosura në përfitim të tretëve;
- j) raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme që do të paraqiten.

ANEKSI 8

KËRKESË PËR AKSES NË SISTEMIN INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES	
Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar një përdorues të ri (të autorizuar) ose për të mbyllur një përdorues ekzistues (të autorizuar).	
Për:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Sektori i Teknologjisë së Informacionit
Nga Banka: _____	Data e kërkesës: __.__.____ (dd.mm.vvvv)

Nr.	Emër Mbiemër i përdoruesit	Adresa e <i>email</i> -it	Veprimi
			Krijim përdoruesi
			Mbyllje përdoruesi
			Krijim përdoruesi
			Mbyllje përdoruesi

Për Bankën	Për Agjencinë
Autorizuesi i kërkesës	Autorizuesi i kërkesës
(_____)	(_____)

ANEKSI 8/1
KËRKESË PËR AKSES NË RRJETIN PRIVAT VIRTUAL (VPN)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES			
Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar përdorues të ri ose për të mbyllur përdorues ekzistues.			
Për:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Nga Banka: _____		Data e kërkesës: __.__.____ (<i>dd.mm.vvvv</i>)	

Nr.	Përdoruesi	Adresa e <i>email</i> -it	Veprimi
			Krijim përdoruesi
			Mbyllje përdoruesi

Për Bankën	Për Agjencinë
Autorizuesi i kërkesës	Autorizuesi i kërkesës
(_____)	(_____)

FORMULARI 2
ANEKS I KONTRATËS SË DEPOZITËS
PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT
FORMULARI I INFORMIMIT TË DEPOZITUESIT

Informacion bazë për sigurimin e depozitave në (emri i institucionit, bankës)	
Depozitat në bankën (emri i Bankës) janë të siguruara nga:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Niveli maksimal i mbulimit:	LEKË 2.500 000 për çdo depozitues në çdo bankë ¹ .
Nëse Ju keni më shumë se një depozitë në bankë:	Të gjithë depozitat tuaja në bankë do të mbliidhen me qëllim përlllogaritjen e nivelit maksimal të mbulimit.
Nëse Ju keni një depozitë të përbashkët me një ose më shumë persona të tjerë:	Niveli maksimal i mbulimit prej 2.500.000 lekësh llogaritet për secilin depozitues më vete.
Periudha e kompensimit në rast të likuidimit të detyruar të bankës:	Jo më vonë se 3 muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.
Monedha në të cilën do të kompensohet depozituesi:	Lek ²
Për më shumë informacion kontakti:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Rruga e Elbasanit, nr. 317, Tiranë info@asd.gov.al, +35542362989, +35542347298
Informacione të tjera:	www.asd.gov.al
Nënshkrimi i depozituesit:	

Informacione shtesë

1. Niveli maksimal i kompensimit.

Në rastin kur me vendim të Bankës së Shqipërisë, banka vendoset në likuidim të detyruar, depozitat tuaja do të kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Shuma e kompensimit është deri në nivelin maksimal 2.500.000 lekë.

Kjo do të thotë që të gjitha depozitat që ju keni në bankën tonë, do të mbliidhen për të përcaktuar nivelin maksimal të mbulimit. Për shembull, nëse ju jeni mbajtës i një llogarie kursimi me 2.300.000 lekë dhe një llogarie rrjedhëse me 1.000.000 lekë, do të kompensoheni në shumën 2.500.000 lekë.

- Në rastin e llogarive të përbashkëta, kufiri prej 2.500.000 lekësh llogaritet për çdo depozitues.

- Në rastin e depozitave me person të autorizuar, sigurohet dhe kompensohet vetëm titullari i depozitës.

- Nëse ju jeni një individ, që keni llogari personale dhe llogari të biznesit tuaj në bankë, ju do të kompensoheni deri në 2.500.000 lekë, si individ, dhe deri në 2.500.000 lekë, si biznes.

- Në rast se ju keni edhe kredi në bankë, nga shuma e llogaritur për kompensim do t'ju zbritet shuma e detyrimeve me vonesë që rezultojnë të pashlyera në ditën e vendosjes së bankës në likuidim të detyruar, nëse ka.

2. Në rastet e transformimit të bankës, nëpërmjet bashkimit ose ndarjes me një bankë tjetër, depozitat tuaja në secilën bankë pjesë e këtij transformimi, mbeten të siguruara më vete për 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të procesit të transformimit.

¹ Agjencia siguron dhe kompenzon depozitat në bankën ... (emri i bankës), por në çdo rast jo më shumë se 2.500.000 lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës së tyre.

² Të gjitha depozitat që janë në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e vendosjes së bankës në likuidim të detyruar.

3. Në përgjithësi, të gjithë depozituesit individë dhe bizneset sigurohen dhe kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Informacioni i përditësuar për përjashtimet për disa depozitues dhe depozita është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Gjithashtu, me kërkesën tuaj, banka do t'ju informojë mbi depozitat e përjashtuara. Nëse depozita është e siguruar, banka e konfirmon këtë edhe në pasqyrën e depozitës suaj.

ANEKSI 17

RAPORTI MUJOR I PËRPUTHSHMËRISË SË BALANCEVE TË DEPOZITAVE SIPAS BILANCIT TË PËRGJITHSHËM ME FORMATIN E FLUKSIT TË DEPOZITAVE TË DËRGUAR NË SISTEMIN INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

në lek

Nr. i klasave	A Emërtimi	B Sipas bilancit ¹ në datën dd.mm.20[vv]	C Sipas raportimit në sistemin e Agjencisë ² në datën dd.mm.20[vv]	D Diferencat	Sqarime për diferencat
	Totali i depozitave të individëve				
	Totali i depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare				
	Totali i depozitave të pasigurueshme				
	<i>Në këtë total përfshihen</i>				
	<i>Llogari rrjedhëse</i>				
1311	Llogari rrjedhëse me bankat rezidente				
1312	Llogari rrjedhëse me institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare rezidente				
1319	Interesi i përllogaritur				
13191	Interesi i përllogaritur për llogaritë rrjedhëse në banka				
13192	Interesi i përllogaritur për llogaritë rrjedhëse në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1321	Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare jorezidente				
1329	Interesa të përllogaritur				
	<i>Depozita pa afat</i>				
1611	Depozita pa afat				
16111	Depozita në banka				
16112	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1629	Interesi i përllogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
	<i>Depozita me afat</i>				
1612	Depozita me afat				
16121	Depozita në banka				
16122	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1619	Interesa të përllogaritur				
16191	Interesi i përllogaritur për depozitat pa afat në banka				
16192	Interesi i përllogaritur për depozitat pa afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				

16193	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në banka				
16194	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1622	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
1629	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
	<i>Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike</i>				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				
2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				
2619	Interesi i përlogaritur				
26191	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë qendrore				
26192	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë rajonale				
26193	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë lokale				
26194	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të tjera				
	<i>Depozita pa afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2631	Qeveria qendrore				
2632	Qeveria rajonale				
2633	Qeveria lokale				
2637	Të tjera				
2639	Interesi i përlogaritur				
26391	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë qendrore				
26392	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë rajonale				
26393	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë lokale				
26394	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të tjera				
	<i>Depozitat me afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2641	Qeveria qendrore				
2642	Qeveria rajonale				
2643	Qeveria lokale				
2647	Të tjera				
2649	Interesi i përlogaritur				
26491	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë qendrore				
26492	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë rajonale				
26493	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë lokale				
26494	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike</i>				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				
2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				

2619	Interesi i përlogaritur				
26191	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë qendrore				
26192	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë rajonale				
26193	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë lokale				
26194	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të tjera				
	<i>Depozita pa afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2631	Qeveria qendrore				
2632	Qeveria rajonale				
2633	Qeveria lokale				
2637	Të tjera				
2639	Interesi i përlogaritur				
26391	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë qendrore				
26392	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë rajonale				
26393	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë lokale				
26394	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të tjera				
	<i>Depozitat me afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2641	Qeveria qendrore				
2642	Qeveria rajonale				
2643	Qeveria lokale				
2647	Të tjera				
2649	Interesi i përlogaritur				
26491	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë qendrore				
26492	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë rajonale				
26493	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë lokale				
26494	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike</i>				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				
2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse</i>				
2711	Individët				
2712	Njësi tregtare dhe industriale private				
2713	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2714	Punonjësit e bankës				
2717	Klientë të tjerë				
2719	Interesi i përlogaritur				
27191	Interesi i përlogaritur për individët				
27192	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27193	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27194	Interesi i përlogaritur për punonjësit e bankës				
27197	Interesi i përlogaritur për klientë të tjerë				

	<i>Llogari depozitash pa afat</i>				
2721	Individët				
2722	Njësi tregtare dhe industriale private				
2723	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2724	Punonjësit e bankës				
2727	Klientë të tjerë				
2729	Interesi i përllogaritur				
27291	Interesi i përllogaritur për individët				
27292	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27293	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27294	Interesi i përllogaritur për punonjësit e bankës				
27297	Interesi i përllogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Llogari depozitash me afat</i>				
2731	Individët				
2732	Njësi tregtare dhe industriale private				
2733	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2734	Punonjësit e bankës				
2737	Klientë të tjerë				
2739	Interesi i përllogaritur				
27391	Interesi i përllogaritur për individët				
27392	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27393	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27394	Interesi i përllogaritur për punonjësit e bankës				
27397	Interesi i përllogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Certifikatat e depozitave</i>				
2741	Certifikatat e depozitave emërore				
27411	Individët				
27412	Njësi tregtare dhe industriale private				
27413	Njësi tregtare dhe industriale publike				
27414	Punonjësit e bankës				
27415	Klientë të tjerë				
274191	Interesi i përllogaritur për individët				
274192	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
274193	Interesi i përllogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
274194	Interesi i përllogaritur për punonjësit e bankës				
274197	Interesi i përllogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Llogari për mbulimin e çeqeve</i>				
2811	Individët				
2812	Njësi tregtare dhe industriale private				
2813	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2814	Punonjësit e bankës				
2815	Klientë të tjerë				
282	<i>Llogari garancie</i>				
2821	Individët				
2822	Njësi tregtare dhe industriale private				
2823	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2824	Punonjësit e bankës				
2825	Klientë të tjerë				
	<i>Llogari të bllokuara për garanci</i>				
2831	Individët				

2832	Njësi tregtare dhe industriale private				
2833	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2834	Punonjësit e bankës	-			
2835	Klientë të tjerë				
2861	Llogari të tjera individë				
2862	Llogari të tjera njësi tregtare dhe industriale private				
2863	Llogari të tjera njësi tregtare dhe industriale publike				
2864	Llogari të tjera punonjës banke				
	Llogari të tjera punonjës për klientë të tjerë				
	Klasa shtesë në varësi të klasifikimit të përdorur ³				

Përgatitur nga: Departamenti

Emri:

Pozicioni:

Data:

Miratuar nga: Departamenti

Emri:

Pozicioni :

Data:

Shënim 1. Korrespondon me totalin e depozitave të raportuar në bilancin e bankës.

Shënim 2. Shuma në lekë duhet të korrespondojë me totalin e balancave të llogarive në lek në kontrollin e të dhënave për flukset depozitë.

Shënim 3. Do të evidentohen klasa shtesë tek e cila raportohen depozita të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare, dhe klientëve të tjerë.

Raportimi sipas këtij aneksi kryhet me format elektronik *Excel* në adresën elektronike sskd@asd.gov.al, brenda datës 15 të çdo muaji.